

VENDIM
Nr.979, datë 2.7.2008

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, TË NJË SIPËRFAQEJE, TRUALL,
KOMUNITETIT TË SANT'EGIDIO-S (SHOQATË JOFITIMPRURËSE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 901 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant'Egidio-s, për selinë dhe veprimtarinë e këtij komuniteti në Shqipëri, të ratifikuar me ligjin nr.9628, datë 30.10.2006, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie, në përdorim, pa shpërblim, për një periudhë njëzetvjeçare, të sipërfaqes prej 1 008 (një mijë e tetë) m², në administrim të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Komunitetit të Sant'Egidio-s (shoqatë jofitimprurëse), për ndërtimin e një qendre të shëndetit mendor, për të pritur dhe rehabilituar persona me probleme të shëndetit mendor.

2. Autorizimin e Ministrisë së Shëndetësisë për të lidhur dhe zbatuar aktmarrëveshjen përkatëse me Komunitetin e Sant'Egidio-s (shoqatë jofitimprurëse), sipas legjislacionit në fuqi.

3. Autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për të lidhur kontratën me këtë komunitet.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha